

Prishtinë,
 24 qershor 2019

Nga: Organizata jo-qeveritare GERMIN

Për: Komisionin për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike

Lënda: Komente rreth Projektligjit për Diasporën

Të nderuar Deputetë të Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike,

Organizata jo-qeveritare GERMIN, e cila ka mision lidhjen e Diasporës me vendin e origjinës, ka përcjellur ecurinë e hartimit të Projektligjit për Diasporën. Në këtë drejtim, GERMIN, poashtu ka dërguar edhe rekomandime tek Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, si iniciatore e këtij projektligji.

Për projektligjin e propozuar dhe votuar më 30 maj 2019, GERMIN pas takimeve në Diasporë dhe diskutimeve virtuale, jep në vazhdim një listë të propozimeve të cilat shpresojmë të adresohen në fazën e fundit të finalizimit të projektligjit. Në tabelën e mëposhtme janë vetëm disa nga pikat kryesore që rekomandojmë të ndryshohen:

<p style="text-align: center;">Neni 4 Marrëdhënia me pjesëtarët e diasporës</p> <p>1. Zhvillimi i marrëdhënieve të Republikës së Kosovës me diasporën bëhet në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin përkatës në fuqi.</p> <p>2. Marrëdhënia me pjesëtarët e diasporës është pjesë integrale e politikës së jashtme të Republikës së Kosovës.</p> <p>3. Ministria ndërton marrëdhënie me pjesëtarët e diasporës për t'i ruajtur kohezionin kulturor, social, politik, arsimor, shkencor, ekonomik etj.</p>	<p style="text-align: center;">Neni 4 Marrëdhënia me pjesëtarët e diasporës</p> <p>Germin rekomandon që të shtohet paragrafi 4, duke garantuar angazhimin e diasporës në procesin e politikëbërjes.</p> <p>“Ministria siguron dhe garanton pjesëmarrjen e pjesëtarëve të diasporës në përpilimin e politikave dhe projekteve që kanë të bëjnë me diasporën.”</p>
<p style="text-align: center;">Neni 5 Bashkëpunimi ndërkombëtarë</p> <p>Republika e Kosovës lidh marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe ndërkombëtare për mbrojtjen e interesave, të drejtave dhe pozitës së pjesëtarëve të diasporës.</p> <p>2. Republika e Kosovës nxit integrimin e pjesëtarëve të diasporës në jetën shoqërore dhe politike në vendet pritëse.</p>	<p style="text-align: center;">Neni 5 Bshkëpunimi ndërkombëtarë</p> <p>Germin rekomandon që të inkuadrohet neni për sigurimet shoqërore përshkak të rëndësisë dhe nevojës. Poashtu, të përfshihet edhe një pikë e cila i obligon Ministrinë përgjegjëse, që lidhjet e marrëveshjeve bilaterale të hulumtohen edhe në aspektin e pasojave të mundshme ekonomike dhe atij të të drejtave qytetare të shtetasve të Kosovës në vendin përkatës</p> <p>3. “Përfshinë ekspertët nga diaspora në procesin e negociimit të marrëveshjeve ndërshtetërore që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kanë të bëjnë me diasporën.”</p>

<p style="text-align: center;">Neni 7 Përgjegjësitë e Ministrisë</p> <p>Përgjegjësitë e Ministrisë përkatëse të Diasporës janë:</p>	<p style="text-align: center;">Neni 7 Përgjegjësitë e Ministrisë</p> <p>Përgjegjësitë e Ministrisë përkatëse të Diasporës janë:</p> <p>Duke marrë parasysh se me udhëzimet administrative nga Ministria e Punëve të Jashtme janë krijuar vështirësi praktike që pjesëtarët e diasporës t'i gëzojnë të drejtat që ju garanton Kushtetuta nga neni 155 dhe Ligji për shtetësinë nent 16, 31,32, rekomandojmë që në draft ligjin për diasporën në nenin 7, pika si 1.19 të shtohet si në vijim:</p> <p>1.19. në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse të Brendshme dhe në përputhje me kornizën ligjore në fuqi kordinon dhe bashkëpunon për përmirësimin e të drejtave të pjesëtarëve të diasporës në fitimin e shtetësisë në bazë të natyralizimit, rikthimin e shtetësisë së Kosovës, dhe gëzimin e të drejtave tjera nga sistemi i gjendjes civile të Kosovës.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 8 Themelimi i Qendrave Kulturore në Diasporë</p> <p>1. Qendrat Kulturore në Diasporë themelohen me qëllim të ruajtjes dhe kultivimit të identitetit kombëtar dhe kulturor të pjesëtarëve të diasporës dhe forcimin e lidhjeve të tyre me Republikën e Kosovës.</p> <p>2. Qendrat Kulturore në Diasporë themelohen në vendet me interes për diasporën dhe për Republikën e Kosovës.</p> <p>3. Me pëlqimin e shtetit pritës, QKD-të mund të veprojnë edhe në kuadër të misionit diplomatik të Republikës së Kosovës në shtetin pritës.</p> <p>4. Përmes marrëveshjeve bilaterale me shtetet që kanë interesa të përbashkëta, Republika e Kosovës mund të themelojë edhe qendra të përbashkëta kulturore.</p>	<p style="text-align: center;">Neni 8 Themelimi i Qendrave Kulturore në Diasporë</p> <p>Germin sugjeron që Qendrat Kulturore të themelohen si <i>fondacione</i>, me përkrahje të limituara financiare nga Qeveria e Kosovës. Ne rekomandojmë që Qendrat Kulturore, si të propozuara nuk duhet të institucionalizohen 100%, por të hapen duke marr shembull modelet e tjera si: British Council, Gotte Institute, L'Alliance Française etj. <i>Sipas modelit të British Council, qendrat e kulturës duhet të kenë një bord menaxhues, i cili mund të përbëhet nga: Përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës dhe Shqipërisë; Përfaqësuesit nga shoqëria civile dhe Përfaqësues nga Diaspora - dhe duke u financuar pjesërisht nga organet qeveritare.</i></p>

<p align="center">Neni 12 Përkrahja për mësimin dhe përparimin e gjuhës zyrtare</p>	<p align="center">Neni 12 Përkrahja për mësimin dhe përparimin e gjuhës zyrtare</p>
<p>1. Ministria përkatëse e Diasporës ndihmon krijimin e kushteve për ruajtjen dhe mësimin e gjuhëve amtare të pjesëtarëve të diasporës ku janë në numër më të madh apo ku ka interes të veçantë shtetëror, në pajtim me kurrikulën përkatëse të vendeve pritëse.</p> <p>2. Ministria inicicion marrëveshje bilaterale me vendet përkatëse ku jetojnë pjesëtarët e diasporës, për përfshirjen e mësimin të gjuhës amtare në kuadër të sistemit arsimor të shtetit pritës.</p> <p>3. Për realizimin e procesit arsimor, sipas paragrafit 1 të këtij neni, Ministria do t'i bashkërenditë dhe do t'i koordinojë punët me shtetet e rajonit me interesa të përbashkëta.</p> <p>5. Ministria, në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse të Arsimit, ndihmon:</p>	<p>Germin rekomandon që të vendoset edhe një pikë e cila obligon Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike dhe Ministrinë përkatëse të Arsimit të aftësojë, trajnojë dhe zgjedhë mësimdhënësit e rinj në diasporë.</p> <p>Ministria, në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse të Arsimit, ndihmon:</p> <p>5.1 “Kualifikimin, trajnimin dhe përzgjedhjen e mësimdhënësve të rinj në Diasporë, bazuar në kurrikulën e re.”;</p> <p>5.2 “Hapjen e shkollave apo klasave të reja aty ku e sheh të nevojshme.”</p>

GERMIN, duke qenë se një kohë të gjatë ka avokuar për shumicën e ndryshimeve që ky projektligj sjellë, jemi të vetëdijshëm që pa avancimin e të drejtave politike, gjë që e cila mungon në këtë projektligj nuk mund të krijojmë një marrëdhënie të frytshme të bazuar në reciprocitet.

Prandaj, ne rekomandojmë që në këtë projektligj të inkuadrohet edhe kapitulli për të drejtat politike. Në këtë kapitull të trajtohet e drejta e votës, si një e drejtë qytetare e garantuar edhe me Kushtetutën e Kosovës, si dhe përfaqësimi i Diasporës. Ne rekomandojmë që projektligji për Diasporën të harmonizohet edhe me rekomandimet e adresuara në Projektligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Kurse sa i përket përfaqësimit, propozojmë që të krijohet Këshilli Kombëtarë i Diasporës, një trup këshilldhënës pranë Kuvendit të Kosovës.

Një tjetër pikë tjetër e rëndësishme e cila propozojmë të përfshihet në këtë projektligj është të krijohet një nen të posaçshëm i cili mbron të drejtat e kthimit në vendlindje të pjesëtarëve të diasporës, si dhe të mbrojë pjesëtarët e diasporës që janë të detyruar të heqin dorë nga nënshtësia kosovare.

Ne besojmë që ndryshimet e draftligjit do të adaptohen edhe konform kërkesave të diasporës dhe në funksion të mbrojtjes së të drejtave shoqërore, politike dhe ekonomike si dhe në ruajtjen e vlerave kulturore dhe identitare.

Me respekt,
 Liza Gashi



Drejtoreshë ekzekutive